

VENDIM
Nr.891, datë 22.12.2004

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.54, DATË 27.2.1992 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SISTEMIN E PAGAVE TË MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK DHE USHTARAKËVE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave “ç” e “dh” të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.54, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Titulli i vendimit zëvendësohet me:

“PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË USHTARAKËVE TË SISTEMIT TË MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK, TË SISTEMIT TË MINISTRISË SË DREJTËSISË DHE TË SISTEMIT TË MINISTRISË SË PUSHTETIT VENDOR DHE TË DECENTRALIZIMIT”.

b) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Numri i klasave dhe madhësia e pagës bazë mujore, për çdo klasë (së bashku me kompensimin e shpenzimeve nga rritja e çmimeve të bukës dhe të disa artikujve ushqimorë për vetë të punësuarin) për ushtarakët e Gardës së Republikës, janë, përkatësisht, sipas Lidhjes nr.1, “Paga bazë sipas klasave për ushtarakët e Gardës së Republikës”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Numri i klasave dhe madhësia e pagës bazë mujore, për çdo klasë (së bashku me kompensimin e shpenzimeve nga rritja e çmimeve të bukës dhe të disa artikujve ushqimorë për vetë të punësuarin) për ushtarakët e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, janë, përkatësisht, sipas Lidhjes nr.2, “Paga bazë sipas klasave për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Numri i klasave dhe madhësia e pagës bazë mujore, për çdo klasë (së bashku me kompensimin e shpenzimeve nga rritja e çmimeve të bukës dhe të disa artikujve ushqimorë për vetë të punësuarin) për ushtarakët e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, janë, përkatësisht, sipas Lidhjes nr.3 “Paga bazë sipas klasave për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Kompensimi, për vetë atë dhe për personat në ngarkim, që ka përfituar çdo ushtarak, bashkohet me pagën bazë mujore.”.

c). Pas pikës 1, shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

“1.1 Ministri i Rendit Publik dhe drejtori i Departamentit të Administratës Publike të përcaktojnë klasën përkatëse të pagës, për çdo pozicion pune, për ushtarakët e Gardës së Republikës, në varësi nga vendi i punës, niveli arsimor, vështirësia në detyrë dhe rrethana të tjera të kësaj natyre.

Ministri i Drejtësisë dhe drejtori i Departamentit të Administratës Publike të përcaktojnë klasën përkatëse të pagës, për çdo pozicion pune, për ushtarakët e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të institucioneve të riedukimit dhe burgjeve, në varësi të saj, sipas vendit të punës, nivelit arsimor, vështirësisë në detyrë dhe rrethanave të tjera të kësaj natyre.”.

ç) Pas pikës 2, shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Ushtarakëve të Gardës së Republikës, të Policisë së Burgjeve dhe të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, që marrin paga sipas Lidhjeve nr.1, nr.2 dhe nr.3 të këtij vendimi, u jepet shtesë mbi pagën bazë mujore, në masën 1 (një) për qind, për çdo vit pune, por jo më shumë se 25 vjet. Për llogaritjen e kësaj shtese të njihet vjetërsia e përgjithshme në punë.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2004, të përballohen nga fondet e miratuara për këtë vit, për paga e sigurime shoqërore, përkatësisht, për Gardën e

Republikës, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i shtrin efektet nga data 1.7.2004.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

LIDHJA Nr.1

PAGA BAZE SIPAS KLASAVE PER PUNONJESIT USHTARAKE
TE GARDES SE REPUBLIKES

Nr rendor	Klasa	Paga baze Mujore ne leke
1	I	10800
2.	II	11000
3.	III	11200
4.	IV	11400
5.	V	11700
6.	VI	11950
7.	VII	12700
8.	VIII	13300
9.	IX	14000
10.	X	15300
11.	XI	15750
12.	XII	16200
13.	XIII	17700
14.	XIV	18500
15.	XV	19300
16.	XVI	20000
17.	XVII	20850
18.	XVIII	23300
19.	XIX	25650
20.	XX	28900
21.	XXI	32150
22.	XXII	40600

PAGA BAZE SIPAS KLASAVE PER PUNONJESIT USHTARAKE
TE POLICISE SE BURGJEVE

Nr rendor	Klasa	Paga baze Mujore ne leke
1	I	10800
2.	II	11000
3.	III	11300
4.	IV	11600
5.	V	12000
6.	VI	12300
7.	VII	12600
8.	VIII	12900
9.	IX	13100
10.	X	13500
11.	XI	13900
12.	XII	14200
13.	XIII	14600
14.	XIV	15000
15.	XV	15500
16.	XVI	16000
17.	XVII	17000
18.	XVIII	19000
19.	XIX	21500
20.	XX	24000
21.	XXI	28000
22.	XXII	38000

PAGA BAZE SIPAS KLASAVE PER PUNONJESIT USHTARAKE
TE POLICISE SE MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPETIMIT

Nr rendor	Klasa	Paga baze Mujore ne leke
1.	I	10800
2.	II	11000
3.	III	11200
4.	IV	11400
5.	V	11700
6.	VI	11950
7.	VII	12700
8.	VIII	13300
9.	IX	14000
10.	X	15300
11.	XI	15750
12.	XII	16200
13.	XIII	17700
14.	XIV	18500
15.	XV	19300
16.	XVI	20000
17.	XVII	20850
18.	XVIII	23300
19.	XIX	25650
20.	XX	28900
21.	XXI	32150
22.	XXII	40600